



Republika e Kosovës
Republika Kosovo – Republic of Kosovo
Kuvendi – Skupština – Assembly

Legjislatura V

Sesioni pranveror

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri

Mbledhja nr. 48/2016

Prishtinë, më 23.2.2016, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, sala S-1

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR ZHVILLIM EKONOMIK,
INFRASTRUKTURË, TREGTI DHE INDUSTRI

Në mbledhje morën pjesë: Muhamet Mustafa - kryetar, Besim Beqaj, Raif Qela, Sala Berisha-Shala, Fatmir Rexhepi dhe Blerim Grainca- anëtarë.

Munguan: Visar Ymeri, Sasha Milosavljeviç, Pal Lekaj, Enver Hoti dhe Duda Balje- anëtarë.

Pjesëmarrës të ftuar: Hykmete Bajrami, ministre për Tregti dhe Industri; Hanefi Muharremi, zëvendësministër i Ministrisë së Infrastrukturës.

Pjesëmarrës të tjerë: Habib Hasani - MI; Fjolla Uka - KDI; Fadil Berjani dhe Avdi Avdiu-Shoqata e Naftëtarëve; Visar Berisha - INDEP; Artë Myftari - ZPRK; Bardha Tahiri dhe Ardi Shita - USAID-CLE dhe Kaltrina Ahmeti- KDI.

Stafi Mbështetës i Komisionit: Armend Ademaj, Besim Haliti dhe Muhamet Morina.

Mbledhjen e kryesoi: Muhamet Mustafa, kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 16.2.2016;
3. Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr.05/L-088 për rregullat e komunikacionit rrugor;
4. Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr.05/L-089 për tregtinë me produkte të naftës dhe karburante të ripërtërishme në Kosovë;
5. Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr.05/L-083 për falimentimin;
6. Shqyrtimi i raportit me rekomandime i Projektligjit nr. 05/L-062 për siguri në punë në veprimtarinë minerare;
7. Të ndryshme.

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës së Komisionit dhe e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendit i ditës u miratua pa vërejtje.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 16.2.2016

Procesverbali i mbledhjes së datës 16.2.2016, u miratua pa vërejtje.

3. Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr.05/L-088 për Rregullat e komunikacionit rrugor

Kryetari i Komisionit, Muhamet Mustafa, tha se për shqyrtimin e Projektligjit për Rregullat e komunikacionit rrugor, janë të ftuar përfaqësuesit e Ministrisë së Infrastrukturës. Ndërsa, për të paraqitur projektligjin, është i pranishëm z. Hanefi Muharremi, zëvendësministër i Ministrisë së Infrastrukturës, të cilit ia dha fjalën për të paraqitur ekspozenë e Projektligjit për rregullat e komunikacionit rrugor.

Hanefi Muharremi, zëvendësministër i Ministrisë së Infrastrukturës, paraqiti ekspozenë e Projektligjit nr.05/L-088 për rregullat e komunikacionit rrugor, në mënyre kronologjike, qëllimin dhe çka e rregullon atë. Ai tha se me qëllim të rritjes së sigurisë në komunikacionin rrugor, duke u bazuar në praktikën e Bashkimit Evropian, është propozuar ndryshimi i Ligjit nr.02/L-70 për siguri në komunikacionin rrugor. Projektligji për rregullat e komunikacionit rrugor ka për qëllim rritjen e sigurisë në komunikacionin rrugor, mbrojtjen e ambientit, të përcaktojë bazat kryesore të ndërsjella të marrëdhënieve dhe sjelljeve të pjesëmarrësve, si dhe subjekteve tjera në komunikacionin rrugor, kushtet bazë që duhet t'i plotësojnë rrugët nga aspekti i sigurisë rrugore, sistemi-sinjalizimi i komunikacionit rrugor, shenjat që japin personat e autorizuar zyrtarë, detyrat në rast aksidenti në komunikacion rrugor, kushtet për drejtimin e mjetit, pajisjet dhe pajimet të cilat duhen t'i kenë mjetet, dimensionet, masa më e madhe e lejuar, ngarkesa boshtore e mjetit, si dhe kushtet të cilat duhet t'i plotësojë mjeti në komunikacion rrugor. Dispozitat e këtij ligji janë të obligueshëm për të gjitha institucionet e Republikës së Kosovës, subjektet e autorizuar, pjesëmarrësve në komunikacion dhe çështje tjera që trajtohen në kuadër të këtij ligji. Për rregullat e komunikacionit rrugor, përmban gjithsej 13 kapituj, me 264 nene. Në këtë projektligj, janë paraparë: Direktiva e BE-së për përdorimin e rripit të sigurisë në mjetet të lehta 3.5 tonë dhe sistemin e sigurisë për lidhjen e fëmijëve në mjet; konsultimi i ministrisë, përkatësisht komunës me komunitetin për çështjet e rrugëve dhe vendosja e sinjalizimit rrugor; për shoferët të cilët nuk e respektojnë kufizimin e shpejtësisë, parashihet dënimi me burg dhe me pikë negative, si dhe për persona që nuk posedojnë patentë shoferë; me qëllim të mbrojtjes së ambientit parashihen veprimet që duhet të ndërmarrin gjatë përdorimit të automjetit, për rritjen e sigurisë në komunikacionin rrugor dhe mbrojtjen e ambientit, do të bëhet kontrollimi i rregullsisë teknike në rrugë - kontrolli teknik mobil; nëse shoferi brenda dy

vitesh ka më pak se 9 (nëntë) pikë, fshihen nga evidenca e shoferit; shoferi i automjetit që brenda një periudhe prej 2 (dy) vitesh ka mbledhur 9 (nëntë) pikë, do t'i shqiptohet masa e ndalimit të drejtimit të mjetit për të gjitha kategoritë për një periudhë prej së paku 12 (dymbëdhjetë) muajsh; shoferi i cili ka qenë i dënuar për shkak 9 (nëntë) pikëve negative dhe pas skadimit të dënimit, brenda 2 (dy) vitesh ka mbledhur 9 (nëntë) pikë negative, i shfuqizohet patentë shoferi dhe duhet prapë t'i nënshtrohet provimit për patentë shofer, si kandidat i ri. Z. Muharremi, në fund theksoi se dispozitat e këtij ligji janë pjesërisht në përputhje me dispozitat e Acquis të BE-së, për fushën e sigurisë.

Kryetari e falënderoi z. Muharremi, për paraqitjen ekspozesë për Projektligjin për rregullat e komunikacionit rrugor dhe tha se është një projektligj gjithëpërfshirës dhe këto ndryshime që janë bërë kanë për qëllim që në të ardhmen të shtohet disiplina dhe kundërvajtjet për shoferët në komunikacionin rrugor. Këto janë disa çështje të propozuara, të cilat janë më pozitive për parandalimin e rreziqeve në komunikacionin rrugor.

Raif Qela, tha se Projektligji për rregullat e komunikacionit rrugor, ka për qëllim të rrisë përgjegjësinë në transportin rrugor. Ai theksoi se brenda projektligjit ka nene ku nuk është zbatuar udhëzimi administrativ i Qeverisë për hartimin e projektligjeve, të cilit udhëzim, nuk i janë përmbajtur më rregullat normative, por kryesorja është që ky projektligj ofron rregulla më të mira se ligji i mëparshëm, dhe gjatë amendamentimit në grupin e punës, do t'i rregullojmë këto çështje normative.

Sala Berisha-Shala, tha se Projektligji për rregullat e komunikacionit rrugor, gjatë fazës së amendamentimit, duhet t'i harmonizojmë çështjet esenciale me Ligjin për patentë shofer. Propozoi që për këtë projektligj, të mbahet dëgjim publik.

Fatmir Rexhepi, theksoi se me Projektligjin për rregullat e komunikacionit rrugor është mirë që janë prekur rreziqet në komunikacion. Pasi të shqyrtohet në parim, duhet t'i kushtohet një rëndësi e veçantë në grupin e punës gjatë amendamentimit, ku duhet të vendosen masa dhe kriteret për të dhënë një disiplinë si preventivë për t'i parandaluar rreziqet në komunikacion rrugor.

Blerim Grainca, tha se Projektligji për rregullat e komunikacionit rrugor është i mirëseardhur, pasi që është një fushë që lë për të dëshiruar. Siç dihet, deri më tani, kemi pasur aksidente të shumta me pasoja njerëzore dhe materiale. Gjatë shqyrtimit, deri në leximin dytë, duhet të definohen qartë raportet në mes të Ministrisë së Infrastrukturës, Policisë dhe Inspektoratit. Lidhur me qendrat e kontroleve teknike, kjo ka bërë që mos të zbatohen kriteret e duhura, pra këtu duhet t'i shtohet rëndësi kushteve dhe kriterëve gjatë kontrollimit të automjeteve. Po ashtu, edhe sigurisë së qarkullimit në trafik, që rrugët të punohen me standardet e përshtatshme për komunikacion rrugor, në mënyrë që siguria e qytetarëve në trafik të jetë më e sigurt, me anë të këtij ligji.

Hanefi Muharremi, zëvendësministër i Ministrisë së Infrastrukturës, tha se të gjitha këto vërejtje, Ministria e Infrastrukturës do t'i marrë parasysh. Ligj për sigurinë në komunikacion,

është ndarë në 3 (tri) pjesë: në atë për patentë shofer; për rregullat e komunikacionit rrugor dhe në Projektligjin për automjetet, i cili do të procedohet së shpejti. Ai theksoi se ministria ka bashkëpunim të ngushtë me Policinë dhe Inspektoratin dhe do të ketë edhe në të ardhmen, me këto institucione. Po ashtu, tha se parashihet nga ministria që të sigurohen pajisjet për kontrollin teknik mobil, në mënyrë që të parandalohen aksidentet e shumta, që po ndodhin në komunikacion. Për çështjen e ndërtimit të rrugëve, është primare nga ministria që të ndërtohen me standarde evropiane.

Besim Beqaj, pyeti për çështjen e kontrollit teknik mobil që parashikohet të bëhet: a është analizuar se si do të rregullohet kjo çështje për sigurinë në rrugë? Theksoi se kontrolli teknik është problem administrativ që duhet të mbikëqyret dhe mos të shpenzohet për kontrollin teknik mobil, pasi që ka kosto shtesë të shpenzimeve dhe projektligji duhet të parasheh, që të ketë kontrolle më të rrepta nga ministria në qendrat e kontrolleve teknike ekzistuese, që janë të licencuara.

Hanefi Muharremi, zëvendësministër i Ministrisë së Infrastrukturës, lidhur me kontrollet teknike mobile, tha se nuk kemi mënyra tjera që t'i kontrollojmë automjetet, po e shikojmë këtë mundësi që të parandalojmë me anë të kontrolleve rutinore, që mund t'i bëjmë nëpër rrugët e Kosovës.

Pas debatit, Komisioni, njëzëri, nxori këtë

Përfundim

1. Miratohet në parim Projektligji nr.05/L- 088 për rregullat e komunikacionit rrugor.

2. I rekomandohet Kuvendit, që ta miratojë në parim Projektligjin nr.05/L- 088 për rregullat e komunikacionit rrugor.

Komisioni vendosi që grupi i punës për shqyrtimin e këtij projektligji, të jetë me këtë përbërje: Raif Qela, kryesues, Sasha Milosavljeviç dhe Sala Berisha – Shala, anëtarë.

4. Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr.05/L-089 për tregtinë me produkte të naftës dhe karburante të ripërtërishme në Kosovë

Kryetari i Komisionit, Muhamet Mustafa, tha se për shqyrtimin e Projektligjit në parim, për tregtinë me produkte të naftës dhe karburante të ripërtërishme në Kosovë, është e ftuar znj. Hykmete Bajrami, ministre për Tregti dhe Industri, të cilës ia dha fjalën për të paraqitur projektligjin në fjalë.

Hykmete Bajrami, ministre për Tregti dhe Industri, paraqiti ekspozenë në mënyrë kronologjike, se çka parasheh Projektligji në sektorin për tregtinë me produkte të naftës dhe karburante të ripërtërishme në Kosovë. Arsyeja për këtë projektligj është përmirësimi i infrastrukturës ligjore, që do të mundësojë transpozimin dhe implementimin e direktivës evropiane për sigurimin e furnizimit me karburante të naftës, direktivës për promovimin e

përdorimit të biokarburanteve në transport, për lehtësimin e procedurave të licencimit, mbrojtjen e ambientit dhe konsumatorit, sigurimin e cilësisë dhe një tregu të barabartë. Projektligj parasheh rregullimin e procesit të lëshimit të lejeve me procedura më të lehta administrative për bizneset dhe në pajtim me ligjet tjera, që tani janë në fuqi. Me këtë projektligj, do të krijohet baza ligjore për përdorim të biokarburanteve në transport, në pajtim me Direktivën 2009/28/EC. Gjithashtu, është kushtëzuar leja e importit dhe e shitjes me shumicë të karburanteve me leje për depo. Disponueshmëria e depove me kapacitetin minimal të nevojshëm, të përcaktuar sipas llojit të karburantit, përveç tjerash, garanton edhe mbrojtjen e mjedisit dhe pronës nga fatkeqësitë të cilat mund të vijnë si rezultat i qëndrimit të produkteve të naftës në vende joadekuate, madje edhe nëpër mauna (autobote), për kohë të caktuar. Sepse, siç dihet, natyra e karburanteve të naftës është e tillë që importi me sasi të vogla dhe pamundësia e shkarkimit në depo krijon kushte për dëmtim të cilësisë, duke paraqitur edhe kërcënim rreth sigurisë dhe dëmtim të ambientit, por edhe vështirëson mbikëqyrjen efikase të tregut të karburanteve. Dispozita të tilla aplikohen në shumicën e vendeve të rajonit dhe vendeve të Bashkimit Evropian, p.sh. Shqipëria, Maqedonia, Kroacia, etj. Risi tjetër e këtij ligji, e cila kontribuon në garantimin e cilësisë së karburanteve dhe transparencës, është përfshirja e dispozitave të cilat do ta obligojnë MTI-në që t'i publikojë në baza mujore listat e operatorëve, të cilët shkelin legjislacionin e naftës, zgjatjes së afatit të lejeve për tregti me produkte të naftës nga dy vite në pesë vite, eliminimi i kërkesës për dokumente të tepruara dhe harmonizimit me Ligjin për leje dhe licenca dhe me ligjet tjera, që tani janë në fuqi. Disponueshmëria e depove, siç parashihet me këtë projektligj, do të krijohen edhe parakushtet për përmbushjen e obligimeve ligjore të Kosovës, të cilat rrjedhin nga legjislacioni i BE-së dhe marrëveshjet të cilat i ka nënshkruar Kosova, që e obligojnë vendin tonë, që deri në vitin 2022, të ketë deri në 150 000 tonë karburant, si rezervë shtetërore. Duhet cekur se kapaciteti aktual i të gjitha depove që ka Kosova, është vetëm 30 000 tonë karburante. Me qëllim të përmbushjes së obligimeve të lartpërmendura, legjislacioni i Bashkimit Evropian parasheh që secili shtet i BE-së duhet të nxjerrë legjislacion nacional, me anë të të cilit duhet t'i obligojë kompanitë vendore, që një pjesë të rezervave shtetërore të naftës, t'i ruajnë në depot e tyre. Kështu që, ne kemi konsideruar se ndryshimet në këtë projektligj, si dhe nxjerrja e Ligjit për rezervat shtetërore të naftës, i cili do t'i dërgohet Qeverisë për një kohë të shkurtër, do të mundësojnë, përveç çështjeve të cilat i renditëm më lart, edhe realizimin e një obligimi, i cili del si detyrë nga legjislacioni i BE-së. Gjatë hartimit të projektligjit, janë konsultuar të gjithë aktorët relevantë, duke përfshirë: Zyrën e Kryeministrit, Ministrinë e Financave, Ministrinë e Administratës Publike, Ministrinë e Drejtësisë, Ministrinë e Punëve të Brendshme, Ministrinë e Integritetit Evropian, Doganën e Kosovës. Pra, përveç institucioneve publike, po ashtu janë konsultuar edhe grupet e tjera të interesit, siç janë organizatat e biznesit, odat ekonomike, shoqata e naftëtarëve dhe grupet e tjera të interesit. Znj. Bajrami, në fund të ekspozesë tha se duke pasur parasysh rëndësinë e këtij projektligji në fushën e ekonomisë, ku me këtë projektligj do të mundësohet krijimi i një mjedisi më të favorshëm dhe më rregullues për funksionimin dhe zhvillimin e sektorit të naftës, propozoi që të miratohet ky projektligj.

Kryetari Muhamet Mustafa, e falënderoi znj. Bajrami për paraqitjen e ekspozesë. Po ashtu, theksoi se ky projektligj do ta rregullojë një sektor shumë të ndjeshëm në treg dhe të rëndësishëm, në aspektin ekonomik. Më tej, tha se duhet të shohim se qëllimi i Projektligjit për tregtinë me produkte të naftës dhe karburante të ripërtërishme në Kosovë, është që të rregullohet çështja e cilësisë dhe testimit, që ende nuk është precizuar saktë. Pra, kjo është rregulluar me udhëzime dhe ende nuk po e shoh një rrol të madh të trupave inspektuese, duhet të shikojmë

funksionin e këtyre trupave inspektuese, çështjen e lejeve të importit dhe kushtëzimin e lejeve të importit me depo. Prandaj, kjo problematikë dhe çështjet e cekura, duhet t'i shohim edhe pasojat që mund të ketë ky ligj në konkurrencën e lirë. Këto gjera duhet t'i shqyrtojmë në mënyrë të gjithanshme, pasi që kemi një numër të madh të pikave shtesë të tregut, që merren me produktet e naftës dhe mund të shkaktojnë probleme në biznese. Ai theksoi se ardhja deri këtu e projektligjit, paraqet një avancim të caktuar dhe duhet diskutuar të gjitha gjërat që mund të vijmë deri te gjetja e zgjidhjes më të mirë.

Raif Qela, tha se Projektligji për tregtinë me produkte të naftës dhe karburante të ripërtërishe në Kosovë, synon që të rregullojë një fushë që ka shumë probleme dhe përpjekjet znj. Bajrami, si ministre për Tregti dhe Industri, kanë qenë që nga fillim i marrjes së kësaj detyre dhe tani ta rregullojë këtë sektor, për të pasur kontroll dhe cilësi në këtë fushë. Unë në këtë projektligj i shoh disa probleme, në veçanti, ku detyrohen që për leje të importit, operatorët patjetër të kenë depo të mëdha për karburante. Kjo, nga njëra anë duket se e mundëson kontrollin më të lehtë të cilësisë, por është vetëm njëri aspekt. Aspekti tjetër është edhe sikur operatorët e vegjël të cilët me këtë projektligj do të kufizohen të importojnë dhe do të detyrohen të marrin prej operatorëve të mëdhenj, të cilët importojnë me shumicë, prapëseprapë do të detyrohemi edhe ato t'i kontrollojmë. Kjo i bie se atë detyrë do ta kemi pavarësisht prej asaj se a kanë depo apo jo. Prandaj, konstatimi se ky kufizim që operatorët të mund të importojnë kur të kenë depot e mëdha për karburante, që mund të importojnë, nuk qëndron. Ky kufizim, duhet të zvogëlohet në masë të konsiderueshme, sepse do t'i godasë një pjesë të madhe të importuesve të sotëm, të cilët nuk janë të fuqishëm, sesa janë një numër i vogël i importuesve të mëdhenj. Prandaj, në nenin 5 duhet të ndalemi dhe ky si tillë duhet të ndryshohet, deri në masën sa nuk e bën dëmtimin e një numri bukur të madh të importuesve të tanishëm të naftës.

Fatmir Rexhepi, tha se për këtë sektor për tregtinë me produkte të naftës, ka pasur debate të ndryshme, por diçka që nuk është rregulluar mirë, është te importuesit e mëdhenj që ju kanë shmangur edhe të hyrave në buxhetin e Kosovës dhe është krijuar një monopol nga një grup njerëzish, qoftë nga biznesi dhe politika. Ai theksoi se për këto ndryshime të propozuara në projektligj, do të kenë sfida. Për licenca, të vendosen rregulla shtesë që t'i disiplinojnë kompanitë, këto janë vërejtje edhe nga kompanitë e vogla dhe të mesme, sepse siç u cek, janë 12 kompani që janë importuese me sasi më të madhe të naftës dhe kanë krijuar një monopol. Ajo që po kërkohet, ndoshta do të ketë një impakt në kompanitë e vogla, që janë përjashtuar nga konkurrenca e lirë. Po ashtu, z. Rexhepi theksoi se gjatë fazës së shqyrtimit në grupin e punës duhet të analizojmë mirë projektligjin, në mënyrë që t'iu përmbahemi atyre politikave që janë stimuluese në favor të gjitha kompanive që janë importues të mëdhenj dhe t'i evitojmë këto mangësi, duke krijuar një konkurrencë të barabartë dhe të lirë.

Blerim Grainca, përgëzoi ministrinë për gjithë këtë punë dhe për sjelljen e Projektligjit për tregtinë me produkte të naftës dhe karburante të ripërtërishe në Kosovë. Po ashtu, tha se qëllimi është i mirë, pra për të rregulluar njëherë e përgjithmonë këtë fushë. Sipas tij, projektligji duhet të rregullohet në përmbajtje, duke pasur si pikë primare çështjen e krijimit të konkurrencës së lirë. Ndërsa, projektligji siç është tani, është në kundërshtim me nenin 10 të Kushtetutës, ku ka të bëjë me ekonominë e tregut dhe konkurrencën e lirë, që është bazë e rregullimit ekonomik në Republikën e Kosovës. Ai theksoi se sot janë 3-5 kompani që kanë monopol të tregut me produktet e naftës, nëse e lemë kështu në heshtje, siç është tani, vërtet do

të ketë monopol dhe kjo i detyron kompanitë e vogla të marrin produktet e naftës nga kompanitë e mëdha, atëherë në bazë të kësaj që është tani në projektligj, e eliminojmë konkurrencën e lirë në mes të importuesve që merren me tregtinë me produkte të naftës. Sipas z. Grainca, kontrolli i cilësisë duhet të bëhet në pikat kufitare, në pikat e shitjes. Po ashtu, deklaratës së konformitetit duhet të mbikëqyrja dhe nuk bëhet kinse në emër të cilësisë t'i dëmtojnë tregtarët e vegjël me pakicë, por duhet që me anë të këtij ligji, t'i mbrojmë interesat e konsumatorëve dhe qyteteve të vendit.

Sala Berisha- Shala, tha se cilësia e naftës, duhet t'u kushtëzohet importuesve me licenca dhe çështja mund të rregullohet me Projektligjin për tregtinë me produkte të naftës dhe karburante të ripërtërishme në Kosovë, ndërsa operatorëve të vegjël nuk mund t'iu krijojmë barriera me ligj, sepse është tregu që e përcakton konkurrencën e lirë. Pyeti: Si është vendosur për rezervat e naftës, të jenë brenda apo jashtë Kosovës?

Besim Beqaj, tha se është tentuar të bëhet diçka më shumë me Projektligjin për tregtinë me produkte të naftës dhe karburante të ripërtërishme në Kosovë, por që ende shumë çështje kanë mbetur të hapura, që të rregullohen me udhëzime administrative. Andaj, projektligji duhet ta specifikojë më qartë cilësinë e naftës, se kush duhet ta mbikëqyrë, në këtë drejtim nuk ka përmirësim. Çështja e rezervave të naftës është e obligueshme edhe është në kuadër të marrëveshjes së MSA-së. Për monopolin, tha se nuk është qasje e drejtë, të favorizohen importuesit e kompanive të mëdha, andaj duhet të jetë liberalizimi i tregut. Lidhur me nenin 5, duhet të specifikohet më qartë dhe të ndryshohet. Ne nuk duhet t'u japim prioritet vetëm kompanive që janë importues me sasi më të madhe. Z. Beqaj, tha se gjatë punës në grupin e punës, do të bëhen amendamentet e nevojshme, për t'i trajtuar të gjithë importuesit e naftës, në mënyrë të barabartë, sepse mund të kemi edhe rritje të çmimit të produkteve të naftës.

Znj. Hykmete Bajrami, ministre e Tregtisë dhe Industrisë, duke iu përgjigjur pyetjeve të deputetëve, tha se kjo formë e projektligjit është një platformë e Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, dhe nëse ka alternativa më të mira, edhe ne do të jemi për ato alternativa. Liberalizimi i tregut nuk rrit cilësinë e naftës. Ne, me këtë projektligj, vetëm po vendosim kriteret për ushtrim të veprimtarisë me naftë dhe produkte të naftës, sqaroi ajo. Me këtë projektligj, askujt nuk i kufizohet e drejta të ketë depo të naftës, theksoi Bajrami. Sipas saj, projektligji ka dispozita, të cilat përcaktojnë që nafta e importuar, fillimisht të deponohet në depo, mandej t'i dërgohet pikave të shitjes së karburanteve me pakicë, dhe kjo ndihmon në rritjen e kontrollit të naftës, sepse në këtë rast nuk ka nevojë të kontrollohet nafta te operatorët e vegjël. Për kontrole të inspektimit, ministria ka blerë një laborator mobil, me të cilin do të bëhen inspektime dhe kontrole në pikat e shitjes së karburanteve, njoftoi znj. Bajrami. Në Kosovë, brenda dite hyjnë një numër i madh i autoboteve dhe nuk ka mundësi që në kufi të kontrollohet nafta e të gjitha autoboteve, sqaroi ministrja. Ajo informoi anëtarët e Komisionit se në treg janë 12 importues, që kanë kapacitete të deponimit dhe askujt tjetër nuk i kufizohet e drejta që të kenë kapacitete të deponimit. Për momentin, janë rreth 50 importues, të cilëve do t'iu vlejné licencat deri në skadimin e tyre. Lidhur me çmimin, ajo tha se ka pasur kërkesa për caktimin e çmimit, por ne si ministri kemi vendosur ta lëmë të hapur dhe konkurrenca të jetë ajo që përcakton çmimin. Sipas direktivave evropiane dhe marrëveshjes së Komunitetit të Energjisë, rezervat e naftës janë të obligueshme për 90 ditë, ndërsa ne kemi kapacitete vetëm për 30 mijë tonë rezerva naftë, andaj kapacitetet për rezerva të naftës kemi obligime që t'i

rrisim, potencoi znj. Bajrami. Sa i përket vlerësimit të dokumenteve në kufi, për importin e naftës, pritet që kjo përgjegjësi t'u kalojë doganave të Kosovës. Po ashtu, foli edhe për ndëshkime me gjoba deri në 150.000 euro, për ato kompani importuese të naftës, që bien ndesh me rregullat ligjore. Për licencat, tha se i kemi 50 importues që kanë licenca për importe të naftës dhe këtu nuk mund të thuhet që ka monopole në këtë sektor, ndërsa për çështjen çmimit, shumë shpejt do të ketë autorizime edhe për laboratorë të tjerë, ndërsa laborator mobil mund të bëjë vlerësime në pika të karburanteve dhe në kufi, tha në fund ministrja Hykmete Bajrami.

Fatmir Rexhepi, pyeti: A ka ndonjë analizë që është bërë deri më sot për cilësinë e naftës në kufi dhe çfarë masash janë marrë, nëse operatorët kanë rënë ndesh me autorizimet? A i është marrë licenca ndonjë operatori?

Hykmete Bajrami, ministre e Tregtisë dhe Industrisë, potencoi se nuk bëhen vlerësimet e cilësisë së naftës për secilin autobot, por mbi përcaktimin e vlerësimit të rrezikshmërisë, kështu që nuk mund të merret si barrierë kontrolli në kufi. Pra, ndaj secilit operator që bën shkelje, duhet të merren masat. Ajo tha se për kompanitë që bien ndesh me ligjin do të ketë ndëshkime, që parashihen deri në 150.000 euro, por për marrjen e licencës vendos gjykata.

Blerim Grainca, potencoi se Projektligji për tregtinë me produkte të naftës dhe karburante të ripërtërishme në Kosovë, së pari duhet të rregullohet në pajtim me Kushtetutën dhe legjislacionit vendor, duke u bazuar në konkurrencën e lirë dhe të barabartë për të gjitha kompanitë që merren me importimin e produkteve të naftës. Prandaj, projektligji duhet rishikohet dhe analizohet deri në detaje, duke e amendamentuar për të lejuar një treg liberal për të gjithë qytetarët.

Kryetari Muhamet Mustafa, tha se në bazë të konkluzioneve mund të vijmë në përfundim, që duhet të rregullohet: çmimi real dhe i favorshëm; cilësia në bazë të standardeve evropiane dhe konkurrenca e lirë në mes të importueseve. Andaj, këto tri çështje që u cekën, duhet të jenë kyçe në rregullimin kësaj fushe dhe të harmonizohen në mes veti. Për depot me rezerva të naftës, për këtë çështje duhet të gjendet një kompromis në mes të kompanive. Për çështjen e cilësisë së produkteve të naftës, trupave inspektuese dhe çështjen e lejeve të importueseve, z. Mustafa theksoi se këto çështje duhet rregulluar mirë dhe qartë, pasi që janë të rregulluara me udhëzime administrativ, prandaj këtu duhet të gjendet një zgjidhje dhe këto çështje do t'i diskutojmë dhe shqyrtojmë më tutje, deri në leximin e dytë.

Pas debatit, Komisioni, njëzëri, nxori këtë

Përfundim

- 1. Miratohet në parim Projektligji nr.05/L-089 për tregtinë me produkte të naftës dhe karburante të ripërtërishme në Kosovë.*
- 2. I rekomandohet Kuvendit, të miratojë në parim Projektligjin nr.05/L-089 për tregtinë me produkte të naftës dhe karburante të ripërtërishme në Kosovë.*

Komisioni vendosi që grupi i punës për shqyrtimin e këtij projektligji, të jetë me këtë përbërje: Fatmir Rexhepi, kryesues, Besim Beqaj dhe Blerim Grainca, anëtarë.

5. Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr.05/L-083 për falimentimin

Kryetari i Komisionit, Muhamet Mustafa, tha se edhe për shqyrtimin e Projektligjit për falimentimin, në parim, është e ftuar znj. Hykmete Bajrami, ministre për Tregti dhe Industri, të cilës ia dha fjalën, për të paraqitur Projektligjin për falimentimin.

Hykmete Bajrami, ministre për Tregti dhe Industri, paraqiti qëllimin dhe arsyen se çka do të rregullojë ky projektligji. Ajo tha se synimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës, është procedimi i përsheptuar i pakos legjislative dhe reformës administrative në funksion të përmirësimit të ambientit të biznesit objektiv të këtij projektligji, është krijimi i bazës ligjore të mirëfilltë për fushën e falimentimit dhe josolvencën e shoqërive tregtare, dispozitat për mbrojtjen, likuidimin dhe shpërndarjen e aseteve të debitorit falimentues te kreditorët dhe dispozita për riorganizimin dhe lirim nga borxhi për shoqëritë tregtare. Me këtë projektligj, rregullohet edhe falimentimi ndërkombëtar, kur një gjykatë e huaj ose nga një përfaqësues i huaj i pasurisë falimentuese, i kërkojnë ndihmë gjykatës kompetente në Kosovë në lidhje me një procedurë të huaj falimentuese, ose kërkohet ndihmë në një shtet të huaj, në lidhje me procedurat e falimentimit sipas këtij ligji; ose kreditorët ose personat tjerë të interesuar në një shtet të huaj kanë interes për të kërkuar fillimin e procedurës ose pjesëmarrjen në procedurë sipas këtij ligji. Përmes këtij projektligji, përcaktohet inicimi dhe hapja e procedurës së falimentimit ndaj debitorit në falimentim, pasojat juridike të hapjes dhe përmbylljes së procedurës së falimentimit, riorganizimin e debitorit në vështirësi financiare, kur ekziston mundësia që debitori të vijë në gjendje falimentimi, riorganizimin e debitorit në vështirësi financiare, kur ekziston mundësia që debitori të vijë në gjendje falimentimi dhe pasojat e lirit nga borxhi të debitorit individual dhe debitorit shoqëri tregtare nga borxhet, pas përfundimit të suksesshëm të riorganizimit, sipas këtij ligji. Ky projektligj, do të zbatohet nga të gjitha shoqëritë tregtare, të rregulluara me Ligjin për shoqëritë tregtare ose me një ligj pasardhës. Gjatë hartimit të koncept-dokumentit, janë konsultuar të gjithë aktorët relevantë, duke përfshirë: Zyrën e Kryeministrit, Ministrinë e Financave, Ministrinë e Administratës Publike, Ministrinë e Drejtësisë, Ministrinë e Integrimeve Evropiane, Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës, Agjencinë për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe Zyrën e Avokatit të Popullit. Përveç institucioneve publike, po ashtu janë konsultuar edhe grupet e tjera të interesit, siç janë: gjykatat, organizatat e biznesit, odat ekonomike etj. Duke pasur parasysh rëndësinë e këtij projektligji në fushën e ekonomisë, me qëllim që të përmirësohet ambienti i bërjes së biznesit, të hiqen dhe reduktohen pengesat burokratike dhe të krijohen lehtësira për bërjen dhe zhvillimin e biznesit, ju propozojmë që ta shqyrtoni dhe miratoni këtë projektligj.

Kryetari i Komisionit, Muhamet Mustafa, tha se Projektligji për falimentimin është një projektligj i hartuar në bazë të standardeve dhe kërkoi nga anëtarët e Komisionit, që sugjerimet dhe vërejtjet e tyre, t'i japin gjatë amendamentimit në grupin e punës, deri në kohën e leximit të dytë të Projektligjit për falimentimin. Në fund, tha se duhet të shikohet dispozita që flet se edhe ndërmarrjet shoqërore nën administrim të AKP-së, i nënshtrohen këtij ligji.

Komisioni, njëzëri, nxori këtë

Përfundim

1. *Miratohet në parim Projektligji nr. 05/L-083 për falimentimin.*
2. *I rekomandohet Kuvendit të miratojë në parim Projektligji nr. 05/L-083 për falimentimin.*

Komisioni vendosi që grupi i punës për shqyrtimin e këtij projektligji, të jetë me këtë përbërje: Besim Beqaj, kryesues, Sala Berisha – Shala dhe Fatmir Rexhepi, anëtarë.

6. Shqyrtimi i raportit me rekomandime i Projektligjit nr. 05/L-062 për siguri në punë në veprimtarinë minerare

Kryetari Muhamet Mustafa, njoftoi se Komisionet e përhershme e kanë shqyrtuar raportin me amendamente për Projektligjin nr. 05/L-062 për siguri në punë në veprimtarinë minerare dhe nuk kanë dhënë ndonjë vërejtje apo propozim, andaj propozoi që të procedohet për lexim të dytë, sipas procedurës.

Komisioni, njëzëri, nxori këtë

Përfundim

1. *Miratohet Raporti me rekomandime i Projektligjit nr. 05/L-062 për siguri në punë në veprimtarinë minerare.*
2. *Raporti me rekomandime t'i procedohet Kuvendit për lexim të dytë.*

7. Të ndryshme

Çështje vijuese

Mbledhja përfundoi në orën 12:45.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetar i Komisionit,

Muhamet Mustafa